



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



ZYRA E PROKURIMIT KOMUNA E PEJËS

Pejë 25.04.2025

Në mbështetje të nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, ligjin nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092 dhe, autoriteti kontraktues Komuna e Pejës (ne vazhdim AK KK PEJE . apo Autoriteti Kontraktues) ka shqyrtuar Kërkesën për Rishqyrtim të operatorit ekonomik **TONI INGJINJERING** pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit Ndertimi i ndriqimit publik ne fshatin Nakell dhe fshatin Gorazhdec te Komunes se Pejës, nrprok te brendeshem. 635-25-014-521// 635-25-3193-5-2-1 dhe ne lidhje me kërkesën, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Cilësohet e **pjeserisht e bazuara** kërkesat për ri-shqyrtim nga operatorit ekonomik **TONI INGJINJERING** pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit : Ndertimi i ndriqimit publik ne fshatin Nakell dhe fshatin Gorazhdec te Komunes se Pejës

SQARIM

Me datën **25.03.2025**, operatoi ekonomik **TONI INGJINJERING** ka parashtruar pranë Autoritetit Kontraktues (**KOMUNA E PEJËS**) kërkesat për rishqyrtim me pretendimet si me poshtë:

Ne Tenderin njoftim per kontratë me titull: : Ndërtimi i Ndriqimit Publik në Fshatin Nakell dhe Fshatin Gorazhdec te Komunes se Pejës

Te kerkesa e pershtatshmeris profesionale keni kerku: Kërkesa 3 Operatori duhet të deshmoj se sistemi menaxhues i ofertuesit permbush kriteret e percaktuara per keto ISO standard -ISO 9001 2015 - Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë -ISO 14001 2015 – Sistemi i Menaxhimit Mjedisor -ISO 45001 2015 - Certifikata për menaxhimin e shëndetit në punë EN - ISO 31000-2018 - Certifikata për Sistemin e Menaxhimit te Riskut

Dëshmia 3 Certifikatat ISO valide per te njejten natyre si projekti (kopje) Vrejtje Çertifikatat e natyres se njejt ISO më të avansuara pranohen

Kerkoi sqarim lidhur me ket kerkese:kerkesa nr.3 te ISO 31000-2018-Certifikata për Sistemin e Menagjimit te Riskut – Kerkoi ng ju si AK që ky projekt qe e kuni shpall a ka te bejë qe ti trajtoni puntoret e komunes per siguri dhe shendet ne punë apo ta ndertoni ndriqimin publik ne ato vende sipas dosjes se tenderit,ju njoftoj si ISO 31000-2018 SKA TE BAJ FARE ME AKTIVITETIN E KTI TENDERIT.-Prandaj duhet larguar kjo qertifikatë si kriter i perzgjedhjes ose ne te vlen qe ne vend te ks j ne ne ofertë te zavendsohet me nji qertifikat tjeter qe i perket lami se ofertes qe e keni inicu.

Kërkesa 2 Një (1) inxhinier i diplomuar ose master i elektros drejtimi elektronike me minimum 5 vite përvojë punë si dhe të ketë minimum (1) projekte nga lëmia e kërkuar pas diplomimit.Të jetë certifikuar ne Sistemin e Menaxhimit te Energjis

Deshmia 3 Për stafin profesional, inxhinieri duhet të kenë diplome, kontrata apo parakontrata në emer të projektit dhe CV-ja e nenshkruar nga vet inxhinierët. Të jetë certifikuar ne Sistemin e Menaxhimit te Energjis

Kerkesa 2. E vendosur nga ju si AK me ket perbajtje është ne kundershtrim me ligjin e prokurimit sidomos na at pjesen qe jan ba disa rregulla qe te mos definojen apo te ceket drejtimi i ingjinerit ku per te njejtin kerkohet edhe nji qertifikat e caktuar, dmth kto vetem emri i ingjinerit apo nr. personal i ti qe nuk po përmendet.

Perveq ksaj kerkesa nuk është transparente sepse kemi ingjiner te qertifikuar nga univerziteti qe shkrun qertifikat dhe titulli i saj është Auditimin e energjisë në ndërtesa dhe ndriqim publik (Auditimin e energjisë në ndërtesa dhe ndriqim publik) dhe qertifiata tjeter është ajo qe leshohet nga kompanit qe lshojn kto ISO.

Kerkoi qe drejtimi i ingjinerit te largohet, te jet ingjiner i elektros dhe qertifikata e kerkuar te largohet si kriter ose ne te vlej si plotsim i kti kriteri edhe qertifikata e leshuar nga univerziteti i Prishtines.

PERGJIGJET E AK NE PRETENDIMIN " ekonomik TONI INGJINJERING

Pas konsultimeve me njësin kërkuese duke u referuara në përgjigje të kërkesës suaj për ri-shqyrtim përjashtim nga kërkesa për **Certifikatën ISO 31000:2018**, ju njoftojmë se:

Kërkesa për paraqitjen e **Certifikatës ISO 31000:2018** është një kriter i përcaktuar në Dosjen e Tenderit, dhe është vendosur për arsye që lidhen **drejtëpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e projektit.**

Projekti "**Ndërtimi i ndriçimit publik në fshatin Nakëll dhe fshatin Gorazhdec të Komunës së Pejës**" përfshin:

- Planifikim teknik dhe instalim të sistemit elektrik në hapësira publike
- Ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese rrugore
- Koordinim me palë të treta dhe faktorë të jashtëm (rrjeti elektrik, rrugët, banorët, etj.)
- Menaxhimin e sigurisë në vendin e punës dhe mbrojtjen e mjedisit

Për këtë arsye, është me rëndësi që **operatori ekonomik të dëshmojë se ka një sistem të implementuar për menaxhimin e rrezikut**, siç parashikon standardi ndërkombëtar **ISO 31000:2018**.

Ky standard ndihmon në:

- Identifikimin dhe vlerësimin e rrezeve gjatë zbatimit të projektit
- Marrjen e vendimeve të strukturuar dhe transparente
- Rritjen e besueshmërisë në zbatimin e kontratës publike

Andaj ju njoftojm se ne kete pike mbete ky kriter. Dhe jemi ne perputheshmeri me LPP-ne dhe rregullat.

Pas konsultimeve të brendshme me njësinë kërkuese dhe shqyrtimit të kërkesave teknike në dosjen e tenderit, ju njoftojmë se është vendosur të **hiqet kërkesa për certifikimin në Sistemin e Menaxhimit të Energjisë** për inxhinierin e propozuar.

Kërkesa që ndryshohet:

"Një (1) inxhinier i diplomuar ose master i elektros drejtimi elektronike me minimum 5 vite përvojë pune si dhe të ketë minimum një (1) projekt nga lëmia e kërkuar pas diplomimit. Të jetë i **certifikuar në Sistemin e Menaxhimit të Energjisë.**"

Formulimi i ri:

"Një (1) inxhinier i diplomuar ose master i elektros drejtimi elektronike me minimum 5 vite përvojë pune si dhe të ketë minimum një (1) projekt nga lëmia e kërkuar pas diplomimit."

Heqja e kërkesës për certifikatë bëhet në përputhje me **Ligjin për Prokurimin Publik (LPP)** dhe rregullat përkatëse, me qëllim që të sigurohet **proporcionaliteti dhe konkurrenca e ndershme** në procedurë.

Ju lutemi referojuni **Formularit B54 – Formulari Standard për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara**, për të gjitha korrigjimet dhe ndryshimet e tjera të aplikueshme në këtë procedurë.

Me respekt

Menaxher i Prokurimit
MILOT GASHI